



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS—REPUBLIC OF KOSOVA—REPUBLIKA KOSOVA INSTITUTI I HISTORISË—INSTITUTE OF HISTORY—INSTITUT ZA ISTORIJU			
Njësia Org. Org. Unit. Org.Jed.	1. 4	Nr. I.prot. Prot.N. Br.Prot.	05/28/22
Nr.i.Faqeve No. Pages Br. Stranica	5	Data: Date: Datum:	11.08.2022
PRISHTINË - A			



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Prishtinë, 11. 08. 2022

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 23, nenet 17-19 të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, Këshilli Drejtues i Institutit të Historisë, në mbledhjen e mbajtur më 11.08.2022, miratoi:

## RREGULLORE

për punën e Këshillit Drejtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri"

### I. Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1

1. Këshillit Drejtues (më tej KD) është organ kolegjal i qeverisjes së Institutit të Historisë "Ali Hadri" (më tej Instituti), ashtu siç përcaktohet me ligj.
2. KD është organi më i lartë udhëheqës dhe vendimmarrës i Institutit.
3. KD harton dhe miraton politikën dhe strategjinë zhvillimore të Institutit, merr vendime dhe aprovon vendimet e organeve të brendshme të tij.

#### Neni 2

#### Përbërja dhe organizimi

1. KD kryesohet nga drejtori i Institutit dhe përbëhet nga 5 anëtarë.
2. Në përbërjen e KD përveç drejtorit, dy anëtarë të tjerë i emëron ministria përkatëse (Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit), ndërsa 2 anëtarë të tjerë, me propozim të Drejtorit, zgjedhen nga Këshilli Shkencor (më tej KSH) nga radhët e punonjësve shkencor të Institutit.
3. Anëtarët e KD duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik dhe me aftësi profesionale nga lëmi i historisë apo shkencave ndihmëse të historisë.
4. Me rastin e propozimit të anëtarëve për KD, nga KSH i Institutit, duhet të respektohet Ligji për Barazi Gjinore.

### **Neni 3**

#### **Mandati**

1. Mandati i anëtarëve të KD është katër (4) vjet.
2. Nëse koha e zgjedhjes së anëtarëve është e ndryshme, plotësimi bëhet sipas procedurave të parapara me këtë Rregullore.
3. Anëtarët e KD të emëruar nga ministria përkatëse mund të shkarkohen në të njëjtën procedurë të zgjedhjes.
4. Anëtarët e KD të emëruar nga Instituti mund të shkarkohen me kërkesë të Drejtorit dhe të miratuar nga KSH.
5. Mandati i anëtarëve të KD mund të ndërpritet edhe me kërkesë të tyre, me rastin e vdekjes dhe me rastin e dënimit me vendim gjykate për vepra penale.
6. Mandati i rregullt i anëtarit të KD ndërpritet edhe:
  - a) Kur anëtari i KD-së konkurren për detyrën e drejtorit të Institutit;
  - b) Kur kryesuesi (drejtori) i KD-së ri konkuron për një mandat shtesë për detyrën e drejtorit të Institutit.

### **Neni 4**

#### **Udhëheqja**

1. Mbledhjet e KD, në koordinim me anëtarët e tjerë, i thërret dhe i udhëheqë kryesuesi i KD.
2. Nëse për shkaqe të arsyeshme kryesuesi nuk mund të marrë pjesë në mbledhje ose në rend dite shqyrtohen çështje që paraqesin konflikt interesi, mbledhjen e udhëheq anëtari më i vjetër i KD-së.
3. Kryesuesi i thërret mbledhjet sipas nevojës. Brenda një muaji mund të thirren deri në katër mbledhje të rregullta.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara.

### **Neni 5**

#### **Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi**

1. Të gjithë anëtarët e KD janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje.
2. Votimi bëhet personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
3. Para se të filloj mbledhja e KD, anëtarët nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i KD mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i KD duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
4. Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
5. Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e KD kujdeset kryesuesi.

6. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se ka kuorum (kuorumi përbëhet prej së paku tre anëtarëve), e lexon rendin e ditës, e hap diskutimin rreth rendit të ditës dhe konstaton miratimin e rendit të ditës.
7. Kryesuesi ia jep fjalën diskutuesit/anëtarit, e konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, e konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit përmes votimit.
8. Anëtarët e KD kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
9. Materialet ose kërkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes, mund të miratohen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

## **Neni 6**

### **Vendimmarrja dhe votimi**

1. Për mbajtjen e mbledhjeve të KD nevojitet shumica e anëtarëve të KD. Vendimet e KD janë të plotfuqishme vetëm nëse kuorumi vërtetohet në kohën e votimit.
2. Vendimet në KD merren me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës.
3. Votimi bëhet i hapur (me ngritje dorë) ose me vota të fshehta. Votimi me vota të fshehta bëhet nëse një gjë të tillë e kërkon së paku një anëtarë i KD-së.
4. Votimi mund të jetë “për”, “kundër” ose “abstenim”.
5. Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi i KD konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.

## **Neni 7**

### **Kompetencat**

1. KD ka këto kompetenca:
  - a. Miraton aktet normative të Institutit;
  - b. Harton Statutin e Institutit. Ndërsa miratimi i tij bëhet sipas Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore neni 21 paragrafi 3.
  - c. Harton dhe Miraton rregulloren e vet të punës;
  - d. Miraton të gjitha vendimet e të gjitha organeve të brendshme të Institutit;
  - e. Miraton planin vjetor të punës së Institutit;
  - f. Miraton raportin vjetor të punës së Institutit;
  - g. Miraton planin financiar të Institutit;
  - h. Miraton raportin financiar të Institutit;
  - i. Zgjedh dhe shkarkon drejtorin e Institutit;
  - j. Miraton dhe anulon konkurset e rekrutimit të stafit të brendshëm, në pajtim me strategjitë zhvillimore;
  - k. Vendos edhe për çështje të tjera në bazë të kësaj Rregullore.

## **Neni 8**

### **Zgjedhja e Drejtorit të Institutit**

1. Drejtori i Institutit zgjedhet në bazë të konkursit publik, të cilin e shpall KD i Institutit.
2. KSH, emëron Komisionin për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit. Komisioni ka për detyrë të konstatojë se cilët prej kandidatëve që kanë konkuruar i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, në pajtim me Ligjin dhe me Statutin e Institutit.
3. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve, i paraqet KSH të Institutit vlerësimin shkencor e profesional për secilin kandidat të paraqitur, si dhe jep propozimin e vet se cilët prej tyre i plotësojnë më së miri kushtet për t'u zgjedhur drejtor i Institutit.
4. Në mbështetje të këtij vlerësimi, KSH i Institutit i propozon KD kandidatët për drejtor të Institutit.
5. Drejtori zgjedhet me votim të hapur me ngritje dore ose të fshehtë me fletëvotim. Nëse zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë, fletëvotimi do t'i përmbajë të gjithë kandidatët e paraqitur në listën e Komisionit të KSH. Secili anëtar i KD ka të drejtë ta rrumbullakojë një kandidat të vetëm në fletëvotim. Fletëvotimet që kanë të rrumbullakuar më shumë se një kandidat do të konsiderohen të pavlefshme. Kandidati i cili e arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm zgjedhet drejtor.
6. Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk arrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në tri radhë votimi, proceduarat e zgjedhjes do të përsëritën nga fillimi, me ri shpalljen e konkursit për pozitën e drejtorit.
7. Për zgjedhjen e drejtorit, KD e njofton MASHTI-n.

## **Neni 9**

### **Zgjedhja e Ushtruesit të Detyrës (më tej UD) së Drejtorit të Institutit**

1. Në qoftë se drejtori nuk emërohet në kohën e duhur, ose pozita e drejtorit mbetet vakante për çfarëdo arsye tjetër, atëherë anëtari më i vjetër nga radhët e KD e thërret mbledhjen për caktimin e UD të Drejtorit dhe e udhëheq KD deri në caktimin e UD të Drejtorit.
2. UD së Drejtorit e zgjedhë KD, nga radhët e punonjësve shkencorë të Institutit.
3. Anëtarët e KD i paraqesin propozimet e tyre për UD të Drejtorit.
4. Për UD të Drejtorit mundë të propozohet personi i cili ka thirrjen shkencore, së paku, Bashkëpunëtor i Lartë Shkencor.
5. Pas zgjedhjes së UD të Drejtorit, kryesuesi i KD e njofton MASHTI-n dhe të njëjtit ja lëshon vendimin për zgjedhjen e UD të Drejtorit.

**Neni 10**  
**Procesverbalet**

1. Në çdo mbledhje të KD mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga procesmbajtësi (i cili caktohet nga Kryesuesi i KD) dhe pas miratimit me shumicë votash edhe nga anëtarët tjerë të KD.
2. Procesverbali duhet të përmbajë:
  - a. Vendin, datën dhe kohën e mbajtjes e mbledhjes;
  - b. Rendin e ditës;
  - c. Propozimet dhe rezultatet e votimit;
  - d. Shënimet thelbësore të diskutimeve dhe të rrjedhës së mbledhjes;
  - e. Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të KD.

**Neni 11**

**Dispozitat Kalimtare**

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdeset kryesuesi i KD.
2. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e jep KD.
3. Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga KD i Institutit.

**Neni 12**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregulloreje mund të behet sipas procedurës së njëjtë të miratimit.

**Kryesuesi i Këshillit Drejtues**  
**Prof. assoc. dr. Teuta Shala-Peli**

